



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Prillogje Më Dita		05.10.2012	
Numri/Broj	Shifra e Klasifikimit	Vlera Wednost	
01-013/1192			

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) dhe nenit 17.1 shkronja f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 10 pika 2 të Ligjit për mbeturina, nenit 36 paragrafi 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 03.10.2012 miraton këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT OPERATIV DHE PLANIT TË
QËNDRUSHMËRISË FINANCIARE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE
NË KOMUNËN E VITISË 2012-2015

Neni 1

MIRATOHET Plani operativ dhe Plani i qëndrueshmërisë financiare për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë 2012-2015

Neni 2

Plani operativ dhe plani i qëndrueshmërisë financiare për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë implementohet sipas dinamikës të paraparë me këtë plan.

Neni 3

Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë formon një komision prej 3 anëtarëve për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit operativ dhe Planit të qëndrueshmërisë financiare për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 4

Mjetet për zbatimin e këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2013.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1 Drejtorisë për Shërbime Publike
2 Shërbimit të Kuvendit
3 Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibaj

